

VENDIM
Nr. 896, datë 21.12.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.206, DATË 9.4.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “FURNIZIMI ME UJË I PLAZHEVE DURRËS-KAVAJË NGA PUSHPIMET E ÇERMËS, LOTI III”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.206, datë 9.4.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3, 4, 5 dhe 6 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë “arë”, me sipërfaqe 5003.5 “pesë mijë e tre pikë pesë) m², me vlerë 1 696 186.5 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë pesë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve.

5. Vlera e përgjithshme, prej 1 696 186.5 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, zëri “investime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, për programin “Furnizimi me ujë dhe kanalizime, zëri “Shpronësim” për objektet buxhetore, me kod projekti M063141.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 5, të këtij vendimi.”.

2. Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit, të dhënat ndryshohen sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË VKM-në NR. 206, DATË 9.4.2014, PAS NDRYSHIMEVE PËRKATËSE TË SIPËRFAQEVE

Nr.	Emri	Mbiemri	Z.K.	Nr. i pasurisë	Arë			Vlera totale (lekë)	Shënime
					sip.shp.(m ²)	çmimi (lekë/m ²)	vlera (lekë)		
1	Sabri	Kacmolli	1031	119/11	2229	339	755631	755631	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Ramazan	Kacmolli	1031	119/14	2774.5	339	940555.5	940555.5	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Shuma:				5003.5			1696186.5	